



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167479
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05747768

KPPP.nr. 78/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit TEB Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Agim Ramadani”, nr. 15, kundër debitorëve 1. N.T.P “Muli”, me numër të biznesit 70415916 dhe me seli në Rahovec, rr. “Krushë e Madhe”, dhe 2. S.B., me adresë në Rahovec, rr. “Krushë e Madhe”, me bazë përmbarimi sipas titullit ekzekutiv, pas shqyrtimit paraprak të lëndës, jashtë seancës, me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit TEB Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.P “Muli”, me seli në Rahovec, dhe S,B.ra, me adresë në Rahovec.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Aktvendimin E.nr. 625/10, të datës 27.02.2013, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit për shitjen në ankand publik sipas titullit ekzekutiv Marrëveshje e Hipotekës me nr. 269 e datës

13.06.2008, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Rahovec me datë 16.06.2008 dhe me Vr.nr. 2130/2008, për borxhin në lartësi prej EUR 11,811.50.

Pasi që aktvendimi për lejimin e përmbarimit ka marrë formën e prerë, lënda në fjalë, fillimisht ishte transferuar pranë Përmbaruesit Privat Sefer Sh. Arifi dhe kishte marrë numrin P.nr. 372/16. Ndërsa duke vendosur sipas kërkesës së kreditorit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të debitorit të dytë, Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me aktvendimin PPP.nr. 7/2020 të datës 15.06.2020 ka ndërprerë procedurën në këtë çështje përmbarimore, për shkak të vdekjes së debitorit të dytë S.M.B..

Duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr. 3739/20, të datës 23.11.2020 e ka prishur vendimin e shkallës së parë PPP.nr. 7/2020 të datës 15.06.2020 dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje pranë të njëjtës gjykatë.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, në rivendosje, me aktvendimin PPP.nr. 34/23 të datës 30.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale në Prishtinë, si gjykatë kompetente për të procedura në këtë çështje përmbarimore.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbarimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje: LPP) janë te përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe*

përsëritja e procedurës në procedurën përmbare. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbareueshëm për përmbareimin me dhunë.”

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbareimit sipas aktvendimit mbi lejimin e përmbareimit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbareimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së.

Gjykata vlerëson se vendosja sipas kërkesës për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, kërkesë kjo që ka qenë objekt shqyrtimi nga Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec me rastin e kthimit të lëndës në rivendosje nga Gjykata e Apelit e Kosovës përmes aktvendimit Ac.nr. 3739/20 të datës 23.11.2020, nuk paraqet mjet juridik në kuptim të nenit 67 dhe 68 të LPP-së për të cilën Gjykata Komerciale është kompetent për vendosje. Andaj në rastin konkret, meqenëse në shkresat e lëndës nuk paraqitet asnjë mjet goditës ndaj vendimit mbi lejimin e përmbareimit për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbareimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbareimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 78/24, datë 29.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.